

## Shtojca 16

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

17/06/2019

Për: "DENIS-05" Shpk, Adresa: TIRANE Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Hamid Shijaku,

#### Procedura e prokurimit: "Procedurë e Hapur"

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-19077-04-22-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "RIKONSTRIKSION I RRUGES LIDHESE TE FSHATIT PEROLLAJ (NJA GOLAJ, HAS)"

Fondi limit (ne qoftese ka lote i ndare ne lote): **20,509,164**(Njëzetmilion e pesëqind e nëntëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. Financimi per vitin 2019 eshte 8,000,000.0 (Tetëmilion) leke perfshire dhe vleften e TVSH-se. Pjesa tjetere do te financohet ne vitin 2020.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): **Buletini i Njoftimeve Publike\_30 Prill, Nr.17, Njoftim Kontrate**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. "DENIS-05" Shpk, numri i NIPT-it: **K51518029B**

Vlera: **20,105,169.0**(Njëzetmilion e njëqind e pesëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh

2. **BO BE-IS&ORUÇI Shpk**, numri i NIPT-eve: **K71412003A & J88511208S**

Vlera: **17,250,492.0** (Shtatëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**BO "BE-IS" Shpk & "ORUÇI" Shpk**, numri i NIPT-eve: **K71412003A & J88511208S**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në skedarët ORUCI\_\_SHPK\_BILANCI\_2016, ORUCI\_SHPK\_BILANCI\_2017, OE nuk ka bashkëngjitur(mungojnë) raporti/n i/e Ekspertit kontabël të autorizuar.

Për sa më sipër nuk është plotësuar një nga kriteret e DST, pika 2.2."Per kapacitetin ekonomik dhe financiar", paragrafi ne të cilin kërkohet: "Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 viteve të fundit ushtrimore (2016, 2017, 2018), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave dhe të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar". **Pikërisht për vitet 2016, 2017 i mungon raporti i Ekspertit kontabël të autorizuar.**

Në skedarin ORUCI\_PUNE\_E\_NGJASHME\_2, kontratë me bashkinë Kukës, që mban Nr.26 Prot, Datë 13/04/2017, me object: "Ndertim i rrjetit te kanalizimeve të Ujrave të Zeza (KUZ), Lagjja Drinas, Kukës **i mungon Marrëveshja e noterizuar** sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; **i mungon Prokura e posaçme** për të vepruar në emër të BO

“ORUÇI”Shpk&”OUEN” Shpk, dhe rraporti i punimeve që janë kryer prej secilit prej Operatoreve, për të gjykuar për volumin, zerat e punimeve apo vlerën e realizuar sipas kontrates. Gjithashtu, i mungon Formulari Vlerësimit sipas shtojcës përkatëse dhe fatura-t Tatimore.

Në skedarin ORUCI\_SHPK\_PUNE\_E\_NGJASHME, kontratë me bashkinë Kukës, që mban Nr.78 Prot, Datë 30/01/2016, me objekt: “Mirembajtje dhe pastrim rruge nga dëbora”, i mungon Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; i mungon Prokura e posaçme për të vepruar në emër të BO dhe kryesorja që: nuk perputhen zerat e punimeve të kontratës mmëssiperme me zerat e objektit prokurimit të AK Bashkia Has (Rikonstriksion i Rruges lidhese të fshatit Perollaj), shtu dhe faktin që nuk ka(nuk është paraqitur) akt-kolaudimi punëve sipas objektit kontratës.

Për sa më sipër nuk është plotësuar një nga kriteret e DST, pika 2.3 ”Per kapacitetin teknik”, paragrafi në të cilin kërkohej që: ”Për kontrata të realizuara me ente publike apo subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Formular Vlerësimi sipas shtojcës Nr. 9; kontratë; situacion përfundimtar; aktin e kolaudimit; faturat tatimore për çdo situacion punimesh”.

Në skedarin ORUCI\_SHPK\_KONTRATE\_PUNE, paraqitet kontrata e drejtuesit teknik z.Agim Elezaj, në skedarin Licenca\_e\_firmes\_+e\_Drejtusit\_teknik[1] është paraqitur licenca drejtuesit teknik, ndër të tjera, drejtuesit teknik z.A.Elezaj i mungon CV dhe Diploma. Gjithashtu paga është e deklaruar (figuron) sipas listë pagesave në shumën 16,000 lekë në muaj, ndërsa në kontratën noteriale të nënshkruar mes palëve, që nga data 19/09/2017 figuron në shumën 38,000 lekë në muaj. Drejtuesi teknik z.A.Elezaj edhe pse ka patur kontratë noteriale të lidhur me OE, deklarimi në “Listepagesat e kontributeve për sigurimet shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” është bërë vetëm nga Korriku 2018 dhe me pagë 16,000 lekë. Për sa më sipër paga është nën atë minimale të përcaktuar me VKM Nr. 399, datë 03.05.2017, VKM Nr. 809, datë 26.12.2018, “PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI”

Në skedarin ORUCI\_SHPK\_INXHINIER\_ELEKTRIK, është paraqitur z.B.Kerxhaliu si ing.Elektrik. Nga verifikimi dokumentacionit rezulton se për z.B.Kerxhaliu mungon CV bashkëngjitur. Nuk është deklaruar në listë pagesa nga Operatori asnjë ditë të vetme, për periudhën e kërkuar nga AK.

Në skedarin ORUCI\_SHPK\_INXHINIER\_NDERTIMI, zj.L.Baji është paraqitur si Ing.Ndertimi, për zj.L.Baji zj.L.Baji zj.L.Baji, ndër të tjera i mungon CV dhe Diploma. Gjithashtu paga deklaruar sipas listë pagesave figuron në shumën 16,000 lekë në muaj, ndërsa në kontratën noteriale të nënshkruar mes palëve, që nga data 19/09/2017 figuron në shumën 38,000 lekë në muaj. Për sa më sipër paga është nën atë minimale të përcaktuar me VKM Nr. 399, datë 03.05.2017, VKM Nr. 809, datë 26.12.2018, “PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI”.

Në skedarin ORUCI\_SHPK\_INXHINIER\_MARKSHAJDER, është paraqitur z.Emri Nerguti si ing.Marshajder(Topograf-Gjeodet). Nga Verifikimi dokumentacionit rezulton që z.Emri Nerguti është i diplomuar si teknik i mesëm në degën Markshejder, përveçse nuk ka CV dhe nuk figuron në listë pagesa sipas kërkesave të DST.

Në skedarin ORUCI\_SHPK\_INXHINIER\_MEKANIK, nga Verifikimi dokumentacionit rezulton që për z.Xhelal Onuzi mungon CV bashkëngjitur, nuk është deklaruar në listë pagesa nga Operatori asnjë ditë të vetme, sipas kërkesave të DST.

Për sa më sipër nuk është plotësuar një nga kriteret e DST, pika 2.3”Per kapacitetin teknik”, paragrafi

në të cilin kërkohet që: *Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Janar 2018 – Mars 2019, si më poshtë:*

*2(dy) inxhinier Ndërtimi; 1 (një) inxhinier Topograf(Gjeodet); 1 (një) inxhinier Hidroteknik; 1(një) inxhinier Elektrik; 1 (një) inxhinier Mekanik; 1 (një) inxhinier Mjedisi (i pajisur me certifikatë nga Ministria e Mjedisit); Për secilin prej tyre duhet të paraqiten dokumenta shoqërues: Diplomë, Kontrata e Punës noteriale, CV.*

Në skedarin ORUCI\_SHPK\_KONTRATA\_E\_MJEKUT, OE “ORUÇI” Shpk **nuk ka paraqitur CV, Diplome, Urdher mjeku(licence)** për mjekun përkatës. Nuk është plotësuar një nga kriteret e DST, pika 2.3, ”Per kapacitetin teknik”, paragrafi në të cilin kërkohet që: *”OE duhet të ketë të siguruar mjek, për të cilin duhet të paraqiten: Diplomë, Kontrata e Punës noteriale, CV, Urdhër Mjeku”.*

Në Skedarët: ORUCI\_SHPK\_KAMION, mjeti i tipit APV, është nën 7 ton, ORUCI\_SHPK\_KAMION\_(2) mjeti i tipit APV, është nën 4 ton(konkretisht =3160 kg), ORUCI\_SHPK\_KAMION\_(4), mjeti i tipit APV, është nën 10 ton, ORUCI\_SHPK\_KAMION\_(5), mjeti i tipit APV, është nën 8 ton, ORUCI\_SHPK\_KAMION\_(6), mjeti i tipit APV, është nën 10 ton, ORUCI\_SHPK\_KAMION\_(7), mjeti i tipit APV, është nën 8.5 ton, ORUCI\_SHPK\_KAMION\_(8), mjeti i tipit APV, është nën 14 ton, ORUCI\_SHPK\_KAMION\_(9), mjeti i tipit APV, është nën 9 ton..

Në Skedarin: ORUCI\_SHPK\_KAMION\_(3), kamioncina me targa AA112CJ, mjeti i tipit ATP, është nën 1.3 ton, nderkohe që kërkohej 3 ton,

Sa më sipër nuk është plotësuar një nga kriteret e **DST, pika 2.3,** ”Per kapacitetin teknik”, paragrafi në të cilin kërkohet që: *”Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”.* Nga sa më sipër kamionat i ka APV(per përdorim të vecantë) nuk janë për çdo transport materiale, dhe pesha është me e vogël se 18 ton për të gjitha mjetet.

**Ndërsa** nga OE “BE-IS” SHPK, pjesë e BO: Për mjetin me targa AA176NB është përdorur (paraqitur) si autobot uji (kontrate qeraje me **KASTRATIN**) nderkohe që **është autobot nafte(sipas certifikatës së mjetit),** po kështu edhe për mjetin me **targa AA095VO është përdorur paraqitur) si autobot uji por në fakt është autobot nafte.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **”DENIS-05” Shpk**, Adresa: TIRANE Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Hamid Shijaku se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **20,105,169.0(Njëzetmilion e njëqind e pesëmjë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkia Has, Sheshi “Dëshmorët e Hasit”, qyteti Krumë** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar-**jo**) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **(nuk jemi në kushtet e nenit 58),** siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 09/06/2019

Ankesa: **(Nuk ka )**

Titullari i autoritetit kontraktor

**Adem LALA**